



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 17 datë 24.12.2024

PËR

MIRATIMIN E LEJES SË ZHVILLIMIT PËR OBJEKTIN: “GLOW TOWER -
GODINË BANIMI, SHËRBIMI DHE HOTELERIE 25 KATE MBI TOKË, ME 6
KATE NËNTOKË”, ME VENDNDODHJE NË RRUGËN “ZENEL BASTARI”,
BASHKIA TIRANË

Në mbështetje të neneve 27, 28 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar; Vendimit Nr.519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit” i ndryshuar, me propozim të subjektit zhvillues shoqërisë “GLOB-3X GROUP” sh.p.k, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e Lejes së Zhvillimit për objektin: “Glow Tower – Godinë banimi, shërbimi dhe hotelerie 25 kate mbi tokë, me 6 kate nëntokë”, në Rrugën “Zenel Bastari”, Bashkia Tiranë, me zhvillues subjektin “GLOB-3X GROUP” sh.p.k.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave dhe Dokumenti i Rregullores së Veçantë i bashkëlidhen këtij vendimi si pjesë përbërëse e tij.
3. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit dhe Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi, pasi nënshkruhet nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Territorit, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit, hyn në fuqi menjëherë.



MINISTËR I LINJËS
MINISTËR I TURIZMIT, KULTURËS DHE SPORTIT
BLENDI GONXHIA



ANËTAR / SEKRETAR I KKTU-SË
DREJTOR I AGENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT



Nënshkruar më datë 10.04 / 2026